



Prishtinë: 03.11.2009

Kodi i ZRRE-së: V_210_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_268_08_09

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_268_08_09;
5. Apelimi i konsumatorit i datës 18.08.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2009 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Hamdi Ismajli (shifra e konsumatorit **DPR - 644**) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE të datës 15.07.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 24.06.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 06.02.2009 ekipi i autorizuar i KEK-ut për ndërrimin e njehsorëve ka larguar nga matja e konsumit të energjisë elektrike njehsorin elektrik me nr. 1981562 dhe kanë vendosur njehsorin e KEK-ut me nr. 4173868
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 009008 i datës 06.02.2009
- Me datë 30.03.2009 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut për verifikim dhe kalibrim të njehsorëve elektrik në Qendrën e Kalibrimit kanë verifikuar njehsorin elektrik me nr. 1981562 dhe kanë konstatuar se: njehsori elektrik vulat shtetërore i ka të falsifikuara, në brendësi të njehsorit faza R është e eliminuar.
Provë: Procesverbali nr. 17/30 të datës 30.03.2009
- Me datë 30.05.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas faturës DPR09HP07743 në shumë prej 923.73 €
Provë: Fatura DPR09HP07743 të datës 30.05.2009

- Me datë 12.06.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 24.06.2009 Departamenti për konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 24.06.2009
- Me datë 15.07.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e KEK-ut në DMK të ZRRE-së
- Me datë 11.08.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar ankesën e konsumatorit lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 11.08.2009
- Me datë 18.08.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_268_08_09.
Provë: Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_268_08_09 dhe** ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** ankesën konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar